



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2010

RELACION

Lenda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-se për 9-mujorin e vitit 2010

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010, është mbështetur në kërkesat me të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhenave personale”.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr.10190 datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”, i ndryshuar, me Ligjin nr.10310, datë 26.07.2010 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10190 udhëzimit nr.1 datë 21.01.2010,” Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010’,
, janë miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhenave personale 1programe buxhetore :

- Programin me emërtimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyres së Komisionerit për mbrojtjen e të Dhenave Personale

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2010-2012. Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP: Mbeshtetja, organizimi, krijimi i kushteve të nevojshme për mirëfunksionimin e KMDP, përafrimin e harmonizimi legjislativ në fushën e të dhenave personale me legjislativin e vendeve të tjera të komunitetit evropian, me të drejtën komunitare si dhe privatesinë, imponimi i legjislativit të sotëm egzistues si dhe ndërgjegjesimin edhe shtrirjen e fushës së zbatimit të ligjit në të gjithë vendin duke garantuar një transparencë totale, intensifikimi i marrëveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e të dhenave personale të shtetasve në lëvizje ose rezident në BE. administrimi e menaxhimi i regjistrat elektronik dhe fizik të subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet në kuadrin e mbrojtjes së të dhenave personale, mbi të cilat KMDP zhvillon përgjegjësitë e saj ligjore, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut .

Në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 12.01.2009 të Ministrisë të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010”, pika 3.6- Raportet e Monitorimit, po ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar-Shtator 2010, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka per qellim ndermarrjen e veprimeve te caktuara ne funksion te realizimit te produkteve dhe arritjes se objektivave te percaktuara per kete program buxhetor.

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave personale , ne baze dhe per zbatim te regjstrit te parashikimeve te vitit 2010, per periudhen 9 mujore, me ndryshimet perkatese ka prokuruar :

KMDP,me buxhetin e rishikuar, i eshte akorduar fondi i planifikuar prej **48.140 .000 leke** i cili perbehet nga:

Me alokimimet dhe rialokimet sipas nevojave me te domosdoshme situata eshte si me poshte vijon

Fondi i Pagave: 26.913 milion (zeri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqerore: 4 milione (zeri 601)

Fondi per Shpenzime Operative: 9 milion e 777 mije leke (zeri 602)

Fondi per Investime: 7 milione leke (zeri 231+230)

Transferime korrente: 450 mije leke (zeri 606)

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave personale , ka realizuar vleren buxhetore ne **28.532.344** leke ose 60%, te fondit te planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore,(zeri 600-601), eshte realizuar ne zbatim te strukturës organizative të miratuar, Nr. 225 dtae 13.11.2008 “Per miratimin e struktures , organikes dhe katekorizimin e pagave te pozicioneve te punes se Komisionerit per Mbrojtjen e te Dhenave Personale numri mesatar i punonjesve eshte realizuar 29 vete, nga 29 vete te miratuar.

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per kete periudhe, eshte realizuar respektivisht; 17.507.766 leke per paga dhe per kontribute per sigurimet shoqerore 2.604.257 leke.

Shmangiet per kete periudhe jane si rezultat i pages se keshilltarit si dhe mungeses se emerimit te specialistit te IT, pas deshtimit te procedurave te konkurrimit per mungese konkurence.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231+230) , nga vlera e pergjithshme prej 7,000,000 leke, per periudhen e raportuar, eshte prokuruar ne shumen 1.143.492 ose rreth 16% te planit vjetor

1. **“Orendi per zyra ”** me fond limit 665 834 leke pa TVSH, per te cilen kane filluar procedurat e tenderimit dhe eshte ne proces eshte organizuar tenderi sipas Urdher Prokurimit nr.58 dt 18.06.2010 me proceduren”Kerkese per Propozim”, tender i cili u fitua nga firma Buna shpk, me seli ne Durres, me vleren 627.900 leke pa tvsh, ne mbeshtetje te kontrates se lidhur nr 208 me date 7.09.2010, duke kursyer 37.934 leke pa tvsh. Tashme eshte kryer pagesa prane Deges se Thesarit por do te paraqitet ne situacionet e tremujorit te fundit te vitit 2010.
2. **“Blerje pajisje kompjuterike “** me fond limit ne vleren 2.310.618 leke pa tvsh, me proceduren”Kerkese per propozim”, sipas Urdher- Prokurimit nr .65 dt 7.07.2010 tender i cili u fitua nga firma private “Sinteza Co” shpk me vleren 2.263.085 leke pa tvsh, ne mbeshtetje te kontrates se lidhur Nr 209 me daten 08.09.2010, duke kursyer fondin prej 47.533 leke pa tvsh. Pagesa nuk u krye ne muajin shtator pasi mallrat u kolauduan sipas specifikimeve teknike dhe tashme eshte kryer prane Deges se Thesarit .

3. **Rikonstrukcion i ambjenteve te brendshme te zyrave te KMDP” me fond limit 1.666.666 leke pa tvsh** proceduren”Kerkese per propozim”, sipas Urdher- Prokurimit nr .60 dt 22.06.2010 tender i cili u fitua nga firma private “Prima konstrukcion “” shpk me vleren 1.141.256 leke pa tvsh, ne mbeshtetje te kontrates se lidhur Nr 209 me daten 08.09.2010, duke kursyer fondin prej 525.410 leke pa tvsh. . Ende nuk eshte kryer pagesa pasi jemi ne fazen e zbatimit te punimeve

Procedurat e prokurimeve dhe te likujdimit per firmat fituese do te ishin kryer me pare por ne zbatim te VKM nr 591 date 23.07.2010“Mbi disiplinimin e shpenzimeve te fondeve Buxhetore ‘ u ndrerpre shpallja e fituesit ne APP si dhe lidhja e kontratave me firmat fituese. Me VKM nr 701 date 25.08.2010 Komisioneri per mbrojtjen e te Dhenave personale lejohet per vijimin normal te te tre procedurave te prokurimit dhe tashme jemi ne fazen e sipercituar.

4. **Blerje software**

Zyra e KMDP eshte pajisur me programin e kontabilitetit “Alfa Buxhetor “ per dy kompjutera ne zyrën e finance-kontabilitetit , program i cili do te lehtesoje dhe permiresoje kryerjen e kontabilizimve dhe ndjekjen e shpenzimeve buxhetore deri ne perfundim dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ne menyre automatike. Vlera e programit eshte ne shumen 140. 000 leke e cila eshte e likujduar sipas kontrates se lidhur mne daten 06.04.2010.

Per Drejtorine e Regjistrimit eshte pergatitur dhe instaluar nje program i cili do te mindesoje njoftimin online te subjekteve kontrollues nepermjet Formularit te Nofitimit , nje databaze per perpunimin dhe regjistrimin e aplikimeve online , regjistrin elektronik te subjekteve kontrollues . Vlera e programit eshte ne shumen 284. 000 leke e cila eshte e likujduar sipas kontrates se lidhur mne daten 21.04.2010.

5.Blerje kondicionere. Fondi i vene ne dispozicion sipas projektit te celur nga Ministria e Financave ne shumen 460.000 leke eshte realizuar ne shumen e 459.600 leke me blerjen dhe instalimin(blerje e vogel) ne zyrat e KMDP te 10 kondicionereve.

6.Blerje te tjera pajisje zyre(perde, abazhure etj) te pergjithshme

Fondi i planifikuar ishte 200.000 me tvsh dhe eshte shpenzuar ne shumen 41.400 leke me tvsh. Shuma prej 41.400 leke me tvsh me fondet e vitit 2010 trajtuar si debitore te vitit te meparshem, eshte likujduar me fondet e vitit 2010 per blerjen e nje piktore , fond i cili per arsye te Deges se thesarit nuk u likujdua dot me fondet e vitit 2009.

Per nevojat e institucionit per furnizimin me uje te pijshem eshte instaluar nje pompe thithese ne shumen 26.500 leke .

Pjesa e mbetur ende nuk eshte prokuruar por pas perfundimit te punimeve te rikonstrukcionit do te perdoret per blerjen dhe pajisjen me mjetet me te domosdoshme te zyrave.

7- **Fondi i investimeve me objekt “Projekt e supervizim)** i miratuar nga ministria e Financave eshte prokuruar pjeserisht per projektin e rikonstrukcionit dhe likujduar ne shumen 192.000 leke . Pjesa e mbetur do te perdoret per likujdimin e supervizionit dhe kolaudatorit ne perfundim te procedures se zbatimit te punimeve dhe situacioneve perfundimtare.

Fondi per shpenzime ne zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2010, me rishikimin e buxhetit te vitit 2010 eshte planifikuar ne vleren 9.777.000 leke. Edhe per kete ze, per periudhen respektive eshte realizuar vlera prej 6.966.829. leke ose 71%, e planit vjetor, duke respektuar kerkesat e detajuara ne Regjistrin e Prokurimeve Publike, te miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike.

Gjithashtu, ne realizimin e shpenzimeve operative, Komisioneri , eshte mbeshtetur ne nje shperndarje sa me racionale te kerkesave, te cilat lidhen me :

- Realizimin e shpenzimeve, te detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, sherbime postare e telefonike per stafin, ne funksion te nje veprimtarie normale institucionale

- Ndergjegjesimin me ligjin nr Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e te dhenave personale”. te kontrolluesve Publike e Private te institucioneve te ndryshme nepermjet organizimit te trajnimeve dhe seminareve.

- Realizimin e shpenzimeve per printime dhe publikime te ndryshme.

Shpenzimet e domosdoshme te planifikuara dhe te miratuara gjejne realizim si vijon:

1. Ruajtje dhe sigurim objekti”, per te cilin eshte zbatuar procedura e blerjeve me vlera te vogla leke ne shumen 463.680 e cila ndahet per likujdim periodikisht
 2. “Blerje kancelarie” dhe “Tонера” per te cilin eshte zbatuar procedura e blerjeve me vlera te vogla leke.
 - 3 . Blerje materiale dhe sherbime te ndryshme, te cilat jane ne procesin e prokurimeve.
- 4- Shpenzimet per mbulimin e udhetimeve e dietave te perfaqesuesve ne konferencat nderkombetare jashte vendit.

Tabela e realizimit te pergjithshem te zerave te vecante dhe fondeve buxhetore per 9-mujorin e pare te vitit 2010 paraqitet sipas tabelës Nr.1

<i>Buxheti</i>	<i>Plani vjetor i rishikuar 2010</i>	<i>Fakti 31.03.2010 2010</i>	<i>Diferenca</i>
600	26,913,000	17.507.766	9.405.234
601	4,000,000	2.604.257	1.395.743
602	9.777,000	6.966.829	2.810.171
231+230	7,000,000	1.143.492	5.856.508
606	450,000	310.000	140.000
	48.140.000	28.532.344	19.607.656

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale , ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji per mbrojtjen e te Dhenave personale te, si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar.

Drejtoresh e Sherbimeve te Brendshme
Lindita Morina